



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përfitim kontrolli nëpërmjet shitjes dhe transferimit të 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.

Përfaqësuesi ligjor i COMDATA S.P.A me shkresën Nr. 330 Prot., i Autoritetit të Konkurrencës, datë 23.05.2018 “Konfirmimi i depozitimit të Dokumenteve”, ka njoftuar lidhur me një transaksionin dhe blerjen nga ana e Comdata S.p.A. të 85% të kuotave të shoqërisë CC Tirana SHPK.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: COMDATA SPA, një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë e cila ofron shërbime “outsourcing” të proceseve të biznesit lidhur me zgjidhjet e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët.

Comdata aktualisht nuk operon në Shqipëri.

Shitësi: Sestante Holding SRL, një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë.

Transaksioni i mësipërm njoftohet pranë Autoritetit pasi shoqëria Sestante Holding SRL, nëpërmjet kontrollit të shoqërisë Intercom Data Service SHPK dhe We Web SHPK, realizon të ardhura në tregun shqiptar.

Intercom Data Service SHPK, një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt dhe ekzistuese sipas ligjeve të Shqipërisë, IDS zotërohet 100% nga shoqëria Sestante Srl dhe është pjesë e marrëveshjes së shitblerjes.

Shoqëria target: CC Tirana SHPK, është themeluar sipas legjislacionit shqiptar me ortak te vetëm shoqërinë Sestante Srl. Objekti i aktivitetit: ofrimi i të gjitha shërbimeve që lidhen me Call Centre dhe Contact Center dhe aktivitet “Back Office”, në fushën e kujdesit ndaj klientit, tele-marketingut apo tele-selling (shitjeve nëpërmjet telefonit) inbound dhe outbound duke përfshirë gjithashtu edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike.

Në datë 26 prill 2018 është lidhur Marrëveshja Kuadër midis Comdata SPA dhe Sestante Holding SRL/Intercom Data Service SHPK për blerjen e 85% të kuotave të CC Tirana SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.